



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG**

---

Numri i lëndës: 2021:215007

Datë: 20.01.2022

Numri i dokumentit: 02626295

**PPP.nr.41/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**, si përmbartimore e përberë nga Gjyqtari individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit B.R B.I me nr. te biznesit ..... me seli në Fsh.K. K-K., përfaqësuar nga S.S av në K., kundër debitorit T. T SH.P.K me nr te biznesit ..... me seli në Fsh D. K-Istog, për shkak të borxhit në shume prej 4,320.00 €, pas prapësimit te ushtruar nga ana e debitori, me dt: 14.09.2021 kundër urdhrimit mbi lejimin e përmbartimit, gjykata jashtë seance me dt.20.01.2022 nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit T. T SH.P.K me nr te biznesit ..... me seli në Fsh D. K-Istog, ushtruar kundër urdhrimit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.127/2021 të dt.24.05.2021, sipas propozimit të kreditorit B.R B.I me nr. te biznesit ..... me seli në Fsh.K. K-K..

**A r s y e t i m**

Kreditori B.R B.I me nr. te biznesit ..... me seli në Fsh.K. K-Kamenic, ka ushtruar propozimin për përmbartimit te përmbartuesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbartimit ndaj debitorit T. T SH.P.K me nr te biznesit ..... me seli në Fsh D. K-Istog, si në shkresat e lëndës me të cilën do të paguaj borxhin në shumë prej 4,320.00 € si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, të gjitha këto ne afat 7 ditor nga dita e pranimit të urdhrimit, në të kundërtën të bëhet bllokimi i llogarive bankare, si dhe te sekuestrohet, regjistrohen dhe shiten sendet e luajtshme dhe te pa luajtshme, e mjetet e mbledhura të transferohen në llogari te përmbartuesit privat, te gjitha këto te specifikuar ne propozimin për përmbartimit te dt.24.05.2021.

Përmbartuesi privat me urdhrin përmbartimit P.nr.127/2021 të dt.24.05.2021, e ka lejuar propozimin për përmbartimit në këtë çështje përmbartimore.

Debitori T. T SH.P.K me nr te biznesit .... me seli në Fsh. D. K-Istog, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me shkrim kundër urdhrin përmbartimor me arsyetimin se lejimi i përmbartimit ne kundërshtim me dispozitat e LPP-së, pasi qe e ka urdhëruar debitorin duke u bazuar vetëm ne një faturë, ku e njëjta nuk është pranuar nga ne e po ashtu nuk i është bashkangjitur propozimit për përmbartim. Me tutje debitori shton se me dt. 12.03.2020, nga kreditori kemi blerë fidanë ne vlerë prej 5000 €, të njëjtën shumë e kemi paguar potë njëjtën ditë, ku si provë gjykatës i dorëzoj faturën dhe pagesën, po ashtu me kreditorin kemi biseduar edhe për fidanë te kumbullave por si kemi porositur asnjë herë dhe nuk kemi pranuar faturë, pasi qe te njëjtat i kemi blerë nga N.P.SH "F. " me seli në Fsh. K. K-Istog, provë fatura nr.07/20 dhe transferi i pagesës i dt. 25.03.2020, andaj nga te lartcekurat i propozoj gjykatës qe ta aprovoj prapësimin dhe ta refuzoj urdhrin përmbartimor.

Kreditori, është njoftuar me prapësimin e debitorit si dhe me mundësin e parashtrimit te përgjigjes, ku me dt.20.09.2021, ka parashtruar përgjigje me arsyetimin se prapsemi i debitorit është i pa bazë pasi qe faturën e ka pranuar dhe nënshkruar vet debitori, po ashtu e njëjta faturë i është bashkangjitur propozimit për përmbartim, ku propozimi për përmbartim është i bazuar ne nenin 21 dhe 29 par.1.3 te LPP-së. Me tutje kreditori shton se nuk është kontestuese se debitori ka blerë fidanë ne vlerë prej 5000 € dhe atë shumë e ka paguar, por se te njëjtën ditë ka porositur dhe blerë ehe fidanë kumbulle ne vlerë prej 4,320 €, por dallimi i vetëm është se faturën qe e kërkojmë me propozim nuk e ka paguar, andaj pretendimet e debitorit janë te pa bazuara dhe nuk ka ofruar prova ashtu siç parashihet ne nenin 69 par.4 te LPP-së dhe kërkojmë qe i njëjti prapsim te refuzohet si i pa bazuar dhe te kompensohen shpenzimet e procedurës për përpilim te përgjigjes.

Gjykata Themelore në Pejë- Dega në Istog, si përmbartimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i pa bazë. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit nuk tregojnë shkaqet sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, sipas të cilave do të pengohet përmbartimi i lejuar nga përmbartuesi privat.

Gjykata pas shikimit te shkresave të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim kur thirret ne atë qe prapësimin ta aprovoj si te bazuar, për shkak se lejimi i përmbartimit ne kundërshtim me dispozitat e LPP-së, pasi qe e ka urdhëruar debitorin duke u bazuar vetëm ne një faturë, ku e njëjta nuk është pranuar nga ne e po ashtu nuk i është bashkangjitur propozimit për përmbartim, te njëjtat pretendime gjykata i refuzoj si te pabazuara pasi qe faturat me te cilin është lejuar përmbartimi, fillimisht e njëjta ju ka bashkangjitur propozimit për përmbartim, e njëjta është ne origjinal, dhe e nënshkruar si nga ana e kreditorit e po ashtu edhe nga ana e debitorit, e sipas nenit 29 par.1.3 dhe par.3 e ne lidhje me nenin 37 dhe 38 te LPP-së, përmbartimi është lejuar konform dispozitave te lartcekura.

Po ashtu sa i përket pretendimeve te debitorit ne prapsim kur thirret ne atë se ne vetëm kemi biseduar por si kemi blerë fidanët tek debitori, por tek një

operator tjetër, lidhur me pretendimet e lartcekura gjykata sqaron faktin se në shkresa e lindës gjendet fatura, e cila është e pranuar edhe nga ana e debitorit, nga e cila faturë vërtetohet fakti se kreditori ju ka shitur 2160 fidane te Kumbullës në vlerë të përgjithshme prej 4,320 €, e me rastin e nënshkrimit të faturës nënkuptohet fakti se është dorëzuar malli i porositur.

Andaj me nënshkrimin e faturës kanë lindur të drejta dhe detyrime në mes kreditorit dhe debitorit, ku kreditori ka pasur për obligim dorëzimin e fidanëve të kumbullës, kurse debitori ta paguaj shumën si në faturë, dhe me rastin e mos kryerjes së detyrave secila nga dy palët ka pasur të drejtë të iniciojë procedurën që të obligohet pala tjetër në përmbushjen e detyrimit konform nenit 4 të LMD-së pasi që palët kontraktuese në krijimin e detyrimeve janë të barabarta.

Nenin 5 i LMD-së parasheh se “Në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit duhet t’i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë”, ndërsa neni 8 par.1 i ligjit të lartcekur parasheh se “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”,

Po ashtu neni 15 I LMD-së parasheh se “Kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës”, andaj me rastin e nënshkrimit të faturës jo vetëm që palët janë marrë vesh për elemente thelbësore të kontratës, por mund të konsiderohet edhe është lidhur kontrata, dhe palët janë dakorduar andaj duke u bazuar në 245 të LMD-së debitori i obligohet pagesën e borxhit kreditori si në propozim, ku par.1 i nenit të lartcekur parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po të njëjtit nen parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”.

Gjithashtu neni 249 par.1 të LMD-së parasheh se “Kreditori ka të drejtë në shpërblim të dëmit të thjeshtë dhe të fitimit të humbur, të cilat debitori është dashur t’i parashikonte detyrimisht në kohën e lidhjes së kontratës, si pasoja të mundshme të shkeljes së kontratës e duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose është dashur detyrimisht t’i kishte të njohura”, ndërsa par.2 i po të njëjtit nen parasheh se “Në rast mashtrimi ose të mos përmbushjes me dashje, si dhe të mos përmbushjes për shkak të pakujdesisë së rëndë, kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitorët shpërblimin e të tërë dëmit, i cili është shkaktuar për shkak të shkeljes së kontratës, pa marrë parasysh atë se kreditori nuk ka ditur për rrethana të veçanta, për shkak të cilave janë shkaktuar ato”.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 21, 29 par.1.3, dhe par.3, 37, 38, 69, 71, 73 par. 3 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, e në lidhje me nenin 4, 5, 8, 15, 245 par.1 dhe 2, 249 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG**  
**PPP.nr.41/2021, dt.20.01.2022**

**GJYQTARI**  
Blerim Istrefi

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.